



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 17

J A N A R 2 0 2 4

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë dhe Pritjet për Inflacionin**

Numër 17

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike  
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

## Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	4
Hyrje -----	4
Përmbledhja e rezultateve -----	4
Kutia 1. Metodologjia -----	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi-----	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	8
Standardet kreditore -----	8
Kushtet dhe rregullat-----	9
Kërkesa për kredi-----	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Standardet kreditore -----	10
Kushtet dhe rregullat-----	11
Kërkesa për kredi-----	12
Financimi -----	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara -----	14
Pritjet për Inflacionin -----	16
Metodologjia -----	16
Përmbledhja e rezultateve -----	16

## Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

### Hyrje<sup>1</sup>

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2023, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2023.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zberthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

### Përmbledhja e rezultateve<sup>2</sup>

Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive vazhdoi me rritje deri në tremujorin e tretë të vitit 2023, mirëpo me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë e reja krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak shënuan rritje më të ulët, përderisa krahasuar me tremujorin paraprak, shënuan rënie të theksuar. Kjo dinamikë mund të reflektoj qasje më të kujdesshme të konsumatorëve në ndërmarrjen e borxheve shtesë në ambient të rritjes së kostos së jetesës, dhe njëkohësisht, qasje dhe monitorim më të kujdesshëm të bankave në kredi-dhënie. Dinamikën në aktivitetin kreditor u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore për kreditë konsumuese, pasi që oferta kreditore kishte ndryshime të vogla gjatë këtij tremujori. Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin që shtytësi i aktivitetit kreditor të jetë kërkesa kreditore, përderisa oferta kreditore pritet të ketë ndryshime pozitive marginale.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua në nivel të ulët nga oferta e lehtësuar marginalisht, përderisa kërkesa kreditore kishte rënie marginale. Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa për NVM-të, kishte lehtësim marginal (tabela 1). Në kontekst të faktorëve që i ndikuan këto zhvillime, rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e mirë në tregjet globale rezultojnë të kenë qenë kontribuuesit kryesor negativ në standardet kreditore. Përderisa, mbështetja nga FKGK dhe pozita e favorshme e likuiditetit kishin ndikim pozitiv deri në një masë në standardet kreditore. Njëkohësisht, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet përgjithësisht rezultojnë me lëvizje marginale pozitive, kryesisht për NVM-të. Për tremujorin e katërt të vitit 2023, në përgjithësi priten lëvizje marginale në standardet kreditore nga bankat, saktësisht pritet një lehtësim marginal për NVM-të (grafik 1). Mbështetja nga FKGK pritet të kontribuoj pozitivisht standardet kreditore. Ndërkohë që pritjet e bankave për efektet e normës së Euribor-it në standardet kreditore rezultojnë të mos kenë ndryshuar (zakonisht rritja e normës së interesit ndikon kërkesën për kredi), pritjet e sektorit për ndikimin e Euribor në kushtet dhe rregullat e kreditimit

<sup>1</sup> Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

<sup>2</sup> Pyetësi dhe seria kohore e rezultateve të AKBK-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

sugjerojnë për dobësim të këtij efekti kundrejt tremujorit paraprak.. Norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rritje deri në një masë kryesisht për kreditë për NVM-të.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u shtrënguan deri në një masë për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Konkretisht, u aplikua shtrëngim në normën e interesit të aplikuar dhe në ngarkesat shtesë përveç interesit. Në anën tjetër, lehtësim në nivel të ulët kishte për kërkesën për kolateral për NVM-të. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht nga rritja e normës së EURIBOR-it dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale. Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK dhe presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave ndikuan pozitivisht kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet. Në tremujorin e ardhshëm, bankat pritet të kenë lëvizje pozitive marginale. Saktësisht, pritet ulje marginale e normës së interesit në kredi për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, gjithashtu pritet lehtësim në kërkesën për kolateral, kryesisht për NVM-të. Këto ndryshime pozitive pritet të nxiten nga mbështetja nga FKGK dhe presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave, ndërsa perspektiva jo e mirë në tregjet globale ndikoi negativisht pritjet e bankave mbi kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, në përgjithësi kishte rënie marginale të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet, e që përbën ndryshim të konsiderueshëm krahasuar me dinamikën e tremujorit paraprak. Saktësisht, kërkesa për kredi nga NVM-të kishte rënie edhe pse në nivel të ulët. Gjithashtu, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë më e ulët në krahasim me pritjet e bankave për TM3 2023, të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2023). Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga ndërmarrjet në përgjithësi u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, prej tyre dy kanë rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rënie të kërkesës. Kjo rënie e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxit kryesisht nga rënia e kërkesës për financimin e investimeve fikse. Indeksi i gjeneruar për pritjet e bankave mbi kërkesën kreditore gjatë tremujorit të ardhshëm, tregon rritje të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Këto pritje bankat ia atribuon kryesisht rritjes së kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues.

Stoku i kredive të ekonomive familjare deri në tremujorin e tretë 2023 shënoi rritje të njëjtë vjetore krahasuar me vitin paraprak. Njëkohësisht, kreditë e reja krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak shënuan rritje të theksuar, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak kishte rënie të kredive të reja. Kjo dinamikë e aktivitetit kreditor të ekonomive familjare u mbështet kryesisht nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore u lehtësua në masë të vogël. Standardet kreditore në tremujorin aktual, në përgjithësi, rezultojnë të kenë lëvizje pozitive më të mëdha se sa pritjet e bankave për të njëjtën periudhë të shprehura në anketën e kaluar. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa ato ndryshuan marginalisht për kreditë konsumuese. Pozita e favorshme e likuiditetit ishte faktori me ndikimin më të madh në lehtësimin e standardeve kreditore për ekonomitë familjare. Njëkohësisht, bankat deklaruan rritje deri në një masë të normës së aprovimit të kredive për ekonomitë familjare. Në tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat presin ndryshime marginale pozitive në standardet kreditore në nivel të njëjtë për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare (tabela 1). Faktori që pritet të ndikoj pozitivisht standardet kreditore është pozita e favorshme e likuiditetit të bankave. Gjithashtu, pritet rritje e përafërt e normës së aprovimit të kredive për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare.






Në përgjithësi, kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u shtrënguan gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në nivel më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive, përmes rritjes së normës së interesit. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte rritja e normës së EURIBOR-it, normë e aplikuar në kreditë me normë variable të interesit. Në anën tjetër, pozita e favorshme e likuiditetit të bankave ishte faktori me ndikimin më të lartë pozitiv në kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e ekonomive familjare. Për tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat në përgjithësi nuk presin lëvizje të rëndësishme të kushteve dhe rregullave për kreditë e ekonomive familjare, përfshirë normën e interesit. Më saktësisht, vetëm dy banka me peshë të ulët në sektorin bankar pritet të aplikojnë norma

më të larta të interesit për të dy llojet e kredive. Për dallim nga tremujori aktual dhe ai paraprak, pritjet për kontribut negativ të rritjes së normës së EURIBOR-it u zvogëluan dukshëm, përderisa normat e interesit pritet të ndikohen pozitivisht duke u stabilizuar në trendin aktual nga presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave dhe pozita e favorshme e likuiditetit në sektorin bankar.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023. Rezulton që kërkesa për kredi shënoi rritje më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive. Saktësisht, pesë banka, prej tyre tre me rëndësi sistemike, raportuan për rritje të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa gjashtë banka, prej tyre katër me rëndësi sistemike, deklaruan rritje për kreditë konsumuese. Nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit ishte faktori i vetëm që kontribuoi pozitivisht, ndërsa faktori me ndikim negativ në kërkesën për kredi ishte rënia e konfidencës së konsumatorëve. Në tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në një nivel të përafërt me atë aktual (tabela 1). Kërkesa për kredi në përgjithësi pritet të nxitet kryesisht nga kërkesa për kreditë konsumuese. Rezultatet e anketës sugjerojnë që kryesisht nevoja për të mbuluar shpenzimet e konsumit pritet ta nxis këtë rritje të kërkesës.

**Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore**

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM3 2023	TM4 2023 (pritjet)	TM3 2023	TM4 2023 (pritjet)
<b>Ndërmarrjet</b>	➔	➔	➔	➔
NVM	➔	➔	➔	➔
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	➔	➔
<b>Ekonomitë familjare</b>	➔	➔	⬆	⬆
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	➔	➔
Kredi konsumuese	➔	➔	⬆	⬆

 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)  
 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)  
 Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)  
 Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)  
 Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Monitorimi prudent i performancës financiare të klientëve dhe vlerësimi më konservativ i aplikacioneve të reja për kredi nga bankat ndihmoi në mirëmbajtjen e nivelit të kënaqshëm të performancës së ri-pagimit të kredive. Sidoqoftë, bankat deklaruan përkeqësim në nivel të ulët të cilësisë së portfolios kreditore si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Në tremujorin e ardhshëm indeksi i gjeneruar pritet të vazhdoj të jetë pozitiv dhe më i lartë për të dy segmentet, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim tutje të cilësisë së portfolios kreditore. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe nga rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Tre banka, ku dy prej tyre me rëndësi sistemike, presin rritje të raportit të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, gjithashtu të njëjtat banka presin të njëjtën dinamikë edhe ekonomitë familjare.

Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u bazua në përgjigjet e nëntë bankave (prej tyre pesë banka me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rritje të financimit. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, krahasuar me tremujorin paraprak rritja ishte pothuajse dyfish

më e lartë. Për dallim nga tremujori paraprak, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve kishte gjithashtu kontribut të konsiderueshëm në rritjen e financimit. Ndërsa, financimi nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare kishte kontribut marginal në financim. Sipas maturitetit, në këtë tremujor të dy afatet e maturimit shënuan rritje të përafërt. Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të gjithësej qasjes në financim përafërsisht në nivel të njëjtë me tremujorin aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar, pasuar nga financimi nga depozitat e ndërmarrjeve. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të jetë e përafërt për të dy afatet e maturimit.

## Kutia 1. Metodologjia

### Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

### Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.




## Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve

#### Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, rezultati për standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi nuk tregojnë lëvizje të rëndësishme. Pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2023), rezultojnë të jenë të përafërta me ndryshimet aktuale në standardet kreditore për ndërmarrjet për TM3 2023 (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuojnë



Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha me indeks negativ 0.07, ndërsa për NVM-të kishte lehtësim marginal me indeks pozitiv 0.08. Faktorët kryesor që ndikuan negativisht standardet kreditore ishin rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e mirë në tregjet globale me një indeks negativ 0.14 dhe 0.17, respektivisht. Përderisa, faktorët që deri në një masë ndikuan pozitivisht standardet kreditore, duke i ofruar siguri sektorit bankar, ishin mbështetja nga FKGK dhe pozita e favorshme e likuiditetit me indeks pozitiv 0.20 dhe 0.13, respektivisht.


Njëkohësisht, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet përgjithësisht rezulton me lëvizje marginale pozitive, kryesisht për NVM-të. Saktësisht, rezultatet gjeneruan indeks marginal pozitiv prej 0.05 për NVM-të, përderisa nuk kishte ndryshim për ndërmarrjet e mëdha.

Standardet kreditore në përgjithësi pritet të kenë lëvizje marginale në tremujorin e ardhshëm. Konkretisht, tetë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan se nuk presin ndryshime në standardet kreditore për ndërmarrjet. Mbështetja nga FKGK pritet të kontribuojë pozitivisht standardet kreditore, përderisa rritja e normës së EURIBOR pritet të kontribuojë negativisht të njëjtat. Ndërsa, norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rritje deri në një masë kryesisht për kreditë për NVM-të.

## Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u shtrënguan deri në një masë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (grafiku 2). Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve shtrëngim u aplikua në normën e interesit të aplikuar dhe ngarkesat shtesë përveç interesit me indeks negativ prej 0.12 dhe 0.09, respektivisht. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e tre bankave, një prej tyre me rëndësi sistemike në sektor. Përderisa, lehtësim deri në një masë kishte në kërkesën për kolateral për NVM-të me indeks pozitiv prej 0.14, e shprehur nga dy banka me rëndësi sistemike. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht nga rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale. Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK-së dhe presioni i konkurrencës në mes të bankave ndikuan pozitivisht kushtet dhe rregullat e aplikuara.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Gjatë tremujorit të ardhshëm, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të kenë lëvizje pozitive marginale. Saktësisht, pritet ulje marginale e normës së interesit për të dy kategoritë e ndërmarrjeve me indeks marginal pozitiv 0.05, dinamikë e ndikuar nga përgjigja e një banke me rëndësi sistemike. Gjithashtu, pritet lehtësim i kërkesës për kolateral kryesisht për NVM-të me indeks pozitiv prej 0.14 e deklaruar nga dy banka më rëndësi sistemike. Këto pritje u ndikuan pozitivisht nga mbështetja e FKGK dhe presioni i konkurrencës në mes të bankave, ndërsa perspektiva jo e mirë në tregjet globale ndikoi negativisht pritjet e bankave mbi kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm.

## Kërkesa për kredi


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rënie në nivel marginal, e që përbën dallim të konsiderueshëm krahasuar me dinamikën e tremujorit paraprak. Saktësisht, përgjigjet gjeneruan indeks negativ prej 0.06 e shprehur nga pesë prej gjithsej dhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistemike, deklaruan rënie të kërkesës për kredi, ndërsa tre banka me peshë më të vogël deklaruan rritje të saj. Kjo rënie u ndikua nga kërkesa për kredi nga NVM-të, me indeks negativ 0.09. Gjithashtu, kërkesa për kredi rezultoi të jetë më e ulët krahasuar me pritjet e bankave për TM3 2023 të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2023) (grafiku 3).

Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga rënia e kërkesës për financimin e investimeve fikse me indeks negativ prej 0.10. Rezultati i faktorëve kontribuues në kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e tre bankave me rëndësi sistemike, prej të cilave dy banka deklaruan rënie të kërkesës për financim të investimeve fikse dhe një bankë deklaroi rënie të kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Cilësia e

aplikacioneve të pranura nga ndërmarrjet nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë TM3 2023.

Sipas anketës, gjatë TM3 2023 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u rrit duke rezultuar me indeks pozitiv 0.10, e që rezulton të ketë ndërruar kahje krahasuar me rezultatin në anketën e kaluar ku përgjigjet e bankave gjeneruan indeks negativ 0.12 të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e gjashtë bankave, ku prej tyre katër banka (dy me rëndësi sistemike) deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese përderisa dy banka tjera (një me rëndësi sistemike), deklaruan rënie të tyre.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Për dallim nga tremujori aktual, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Konkretisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave (një me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi. Kërkesë deri në një masë më të lartë pritet të ketë nga ndërmarrjet e mëdha. Këto pritje bankat ia atribuon kryesisht rritjes së kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Cilësia e aplikacioneve të pranura për kredi pritet të ketë ndryshime marginale negative për NVM-të dhe ndryshime marginale pozitive për ndërmarrjet e mëdha.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të rritet tutje me indeks pozitiv 0.13, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe rënies së fuqisë blerëse të klientëve. Tre banka, ku dy prej tyre me rëndësi sistemike, presin rritje të raportit të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, përderisa një bankë pret rënie të këtij raporti.


## Kreditë ndaj ekonomive familjare

### Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023 përgjithësisht patën lëvizje marginale pozitive. Lehtësim kryesisht u aplikua për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv marginal prej 0.09, bazuar në përgjigjen e një banke me rëndësi sistemike. Pritjet për tremujorin aktual, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar (TM2 2023), rezultuan më të ulëta se sa vlerat aktuale (grafiku 4). Pozita e favorshme e likuiditetit ishte faktori me ndikimin më të madh në lehtësimin e standardeve kreditore për ekonomitë familjare.

Bankat deklaruan rritje të normës së aprovimit të kredive për ekonomitë familjare, saktësisht për kreditë për blerjen e shtëpive indeks pozitiv prej 0.18, ndërsa për kreditë konsumuese indeks pozitiv prej 0.15.

**Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan**




Në tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat presin ndryshime margjinale pozitive në standardet kreditore në nivel të njëjtë për të dy llojet e kredive të ekonomive familjare. Faktori që pritët të ndikoj pozitivisht standardet kreditore është pozita e favorshme e likuiditetit të bankave. Bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive për ekonomitë familjare. Konkretisht, pritët rritje e normës së aprovimit të kredive për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.18 dhe për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.20.

### Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht kishin lëvizje negative në tremujorin e tretë të vitit 2023. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në nivel më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive krahasuar me kreditë konsumuese. Saktësisht, bankat aplikuan norma më të larta të interesit për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks negativ prej 0.20, rezultat i ndikuar nga përgjigjet e tre bankave (dy prej tyre me rëndësi sistematike) të cilat rritën normat e interesit për kreditë për blerjen e shtëpive. Ndërsa, për kreditë konsumuese norma e interesit u rrit nga dy banka (një prej tyre me rëndësi sistematike) duke gjeneruar indeks negativ prej 0.11. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte rritja e normës së EURIBOR-it, normë e cila kryesisht aplikohet në kreditë me normë variable të interesit (grafiku 5). Pozita e favorshme e likuiditetit të bankave ishte faktori më i lartë pozitiv në kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e ekonomive familjare.

**Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare**



Për tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat në përgjithësi nuk presin lëvizje të rëndësishme të kushteve dhe rregullave për kredi për ekonomitë familjare. Shtrëngim i kushteve dhe rregullave pritet të aplikohet përmes rritjes së normës së interesit për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare vetëm nga dy banka me peshë më të vogël në sektorin bankar, e që rrjedhimisht gjeneruan një indeks marginal negativ prej 0.04. Për dallim nga tremujori aktual dhe ai paraprak pritet për kontribut negativ të rritjes së normës së EURIBOR-it u zvogëluan dukshëm, përderisa të njëjtat pritet të ndikohen pozitivisht nga presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave dhe pozita e favorshme e likuiditetit në sektorin bankar.


### Kërkesa për kredi

Pas gjenerimit të rezultateve për kërkesën kreditore në këtë tremujor, rezultojnë që kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje, mirëpo më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak. Nëse e zbërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezultojnë që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.20, ndërsa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.14. Saktësisht, pesë banka, prej tyre tre me rëndësi sistemike, raportuan për rritje të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa dy banka tjera (një prej tyre me rëndësi sistemike) raportuan për rënie të kërkesës për të njëjtat. Për kreditë konsumuese, gjashtë banka, prej tyre katër me rëndësi sistemike, deklaruan rritje të kërkesës dhe dy banka tjera (një prej tyre me rëndësi sistemike) raportuan për rënie të kërkesës për të njëjtat. Nëse krahasojmë rezultatet të kërkesës aktuale për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i lartë (grafiku 6).

Faktori i vetëm që ndikoi pozitivisht dinamikën në kërkesën për kredi ishte nevoja për financimin e shpenzimeve të konsumit (indeks pozitiv 0.36), ndërsa faktori me ndikim negativ në kërkesën për kredi ishte rënia e konfidencës së konsumatorëve (indeks negativ 0.10). Njëkohësisht, cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare shënoi rënie me një indeks marginal negativ për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa cilësia e aplikacioneve për kreditë konsumuese shënoi rritje marginale.

Bankat deklaruan përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bazuar në indeksin pozitiv prej 0.09, mirëpo që është në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Dinamikë e ndikuar nga përgjigjet e tre bankave, ku dy prej tyre me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuojnë



Në tremujorin e katërt të vitit 2023, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare pritet të ketë rritje të përafërt me tremujorin aktual. Konkretisht, bankat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese me indeks pozitiv prej 0.23 dhe për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.13. Pritjet për këtë dinamikë, u ndikuan nga përgjigjet e katër bankave (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat

presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive dhe gjashtë bankave (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese. Rezultatet e anketës sugjerojnë që kryesisht nevoja për të mbuluar shpenzimet e konsumit pritet ta nxis këtë rritje të kërkesës dhe në një nivel më të ulët perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive. Bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi.

Gjatë TM4 2023, bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet tutje, bazuar në vlerën pozitive të indeksit. Saktësisht, pritjet e bankave për raportin e kredive jo-performuese rezultuan në indeks pozitiv 0.16, deklaruar nga tri banka, ku dy nga to janë banka me peshë të lartë në kreditim dhe me rëndësi sistemike.


## Financimi

Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u bazua në përgjigjet e nëntë bankave (prej tyre pesë banka me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rritje të financimit.

Bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve, gjatë këtij tremujori gjithsej financimi shënoi rritje dyfish më të lartë krahasuar me tremujorin e kaluar, saktësisht indeks pozitiv 0.57 (indeks pozitiv 0.28 në TM2 2023). Gjithashtu, depozitat e ekonomive familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.63, pothuajse dyfish më i lartë krahasuar me tremujorin paraprak (indeks pozitiv 0.35). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e nëntë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre pesë janë banka me rëndësi sistemike, dhe tutje një nga këto banka deklaroi rritje të konsiderueshme të depozitave nga ekonomitë familjare. Për dallim nga tremujori paraprak, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve kishte gjithashtu kontribut të konsiderueshëm në rritjen e financimit pasi që gjeneroi indeks pozitiv 0.58 (indeks pozitiv 0.03 në TM2 2023), duke reflektuar përgjigjet e tetë bankave pjesëmarrëse, ku prej tyre pesë janë banka me rëndësi sistemike, dhe tutje një nga këto banka deklaroi rritje të konsiderueshme të depozitave nga ndërmarrjet. Financimi nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare kishin kontribut marginal në financim me indeks negativ 0.09 dhe indeks pozitiv 0.09, respektivisht, të deklaruar nga një bankë me rëndësi sistemike (grafiku 7). Sa i përket maturitetit të financimit, në këtë tremujor rritje të përafërt kishte për të dy afatet e maturimit. Konkretisht, depozitat afatgjata gjeneruan indeks pozitiv prej 0.30, ndërsa ato afatshkurtra gjeneruan indeks pozitiv prej 0.28.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të gjithsej qasjes në financim përafërsisht në nivel të njëjtë me tremujorin aktual me indeks pozitiv prej 0.56, e deklaruar nga nëntë banka pjesëmarrëse në anketë. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.53, pasuar nga financimi nga depozitat e ndërmarrjeve me indeks pozitiv prej 0.44, deklaruar nga tetë banka të cilat presin rritje të këtyre burimeve të financimit dhe një banke më peshë të vogël e cila pret rënie të financimit nga të njëjtat burime. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të jetë e përafërt për të dy afatet e maturimit. Konkretisht, pritet rritje e financimit afatshkurtër me indeks pozitiv 0.36 dhe financim afatgjatë me indeks pozitiv 0.35 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



### Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësori i anketës për tremujorin e tretë të vitit 2023 është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zbrërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Të nxitur nga dinamikat e çmimeve në vend dhe globalisht, si dhe nga presionet e vazhdueshme gjeopolitike, një numër i faktorëve ndikuan në vlerësimet dhe pritjet për rreziqet në rritje ndaj sektorit bankar në vend dhe globalisht. Në këtë kontekst, për të kuptuar më hollësisht vlerësimet dhe pritjet e bankave në vend, në anketë u përfshinë pyetje mbi rreziqet më eminente të sektorit gjatë tremujorit të tretë, dhe tutje pritjet e bankave për gjashtëmujorin e ardhshëm.

Gjatë tremujorit të tretë nuk kishte materializim të rreziqeve, sidoqoftë disa nga bankat e cilësuan profilin e rrezikut të bankës si mesatar dhe nën vëzhgim. Kështu, bankat treguan kujdes të shtuar në monitorimin e rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të normës së interesit, të cilat u ndikuan nga rritja e pasigurisë në sigurimin e financimit, nga lëvizja e normave të interesit, dhe nga ndikimi i çmimeve në kapacitetet ri-paguese të klientëve. Për gjashtë muajt e ardhshëm bankat identifikuan disa prej faktorëve që pritet të ndikojnë rreziqet në përgjithësi dhe të cilëve bankat janë duke i kushtuar vëmendje të veçantë. Këta faktorë përfshijnë zhvillimet politike në vend dhe zhvillimet gjeopolitike në nivel global, mungesën potenciale të fuqisë punëtore në tregun vendor (sidomos në sektorë të caktuar ekonomik, si ndërtimtaria e shërbimet) ose rrezikun potencial të emigrimit të rinjve pas liberalizimit të vizave, pritjet për aktivitet të dobësuar ekonomik, rritjen potenciale dhe nivelin e lartë të normës së EURIBOR, si dhe vazhdimësinë e nivelit të lartë të çmimeve në vend (kostos e lartë e jetesës).

Pyetësori i anketës për TM3 2023 përfshin një pyetje shtesë mbi perceptimin e bankave dhe pritjet mbi rrezikun e likuiditetit. Rezultatet e gjeneruara treguan se gjysma e bankave të anketuara e cilësuan si rrezik të ulët rrezikun nga pozicioni i likuiditetit, bazuar në treguesit e likuiditetit të cilët qëndruan mbi minimumin e kërkuar rregullator, si dhe njëkohësisht, kontrollin e rregullt të treguesve përkatës. Këto banka kanë peshë të lartë dhe bazë stabile të financimit në sektor. Anketa sugjeron se sektori ka ndërmarr masa për menaxhimin dhe reduktimin e efekteve të mundshme nga rreziku i likuiditetit përmes rritjes së normave në depozita, kampanjave me kushte të favorshme për tërheqjen e depozitave, si dhe menaxhimin më të kujdesshëm të kreditimit. Tutje gjatë gjashtëmujorit në vazhdim, bankat parashohin që rreziku i likuiditetit të jetë i qëndrueshëm mirëpo nën vëzhgim të afërt, meqë pritet të ndikohet nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare dhe konkurrenca e ashpërsuar e sektorit bankar në tërheqjen e depozitave. Në rast të rritjes së ekspozimit ndaj këtij rreziku, bankat shohin si mekanizëm mbështetës financimin/ndihmën nga bankat amë, si dhe Planin Rezervë të Likuiditetit, si opsione të mundshme, megjithëse nuk ka pritje të tilla.

Referuar ndjeshmërisë së bilancit të gjendjes ndaj rritjes së normave të interesit, në përgjithësi, bankat e cilësuan si rrezik mesatar. Konkretisht, bankat me peshë më të madhe në sektorin bankar e cilësuan si rrezik jo të lartë apo të limituar, përderisa bankat me peshë më të vogël shprehën ndjeshmëri më të lartë të zërave bilancor ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Këtë vlerësim një pjesë e bankave e bazuan duke iu referuan skenarëve të sensitivitetit ndaj ndryshimit të normës së interesit prej +/- 200 pp në pozicionet e librit të bankës sipas “Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Normës së Interesit në Librin e Bankës”, dhe pjesëmarrjes së normave variable në portofolion e tyre kreditore. Bankat me peshë më të ulët në sektorin bankar shprehen ndjeshmëri më të lartë në anën e detyrimeve, kjo për shkak të pozitës më të pafavorshme në aspektin e sigurimit të financimit më stabil. Gjithashtu, ato theksuan ndikimin negativ të këtij rreziku në profitabilitetin e bankës. Si masë për menaxhimin e këtij rreziku një pjesë e madhe e bankave e shohin aplikimin e normave variable të interesit.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të tretë 2023, standardet kreditore kishin ndryshime margjinale në disa prej sektorëve ekonomik. Rezultat marginal negativ, që nënkupton shtrëngim të standardeve kreditore, kishte për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ 0.08. Në anën tjetër, rezultat marginal pozitiv, apo lehtësim të standardeve kreditore, kishte për sektorin e shërbimeve dhe të tregtisë me indeks pozitiv 0.08, ndërsa për sektorët tjerë standardet kreditore nuk ndryshuan. Kushtet dhe rregullat u shtrënguan në masë më të madhe për të gjithë sektorët, e veçanërisht për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ prej 0.20, dhe për sektorin e patundshmërive (rezidenciale dhe komerciale) me indeks negativ prej 0.12. Shtrëngime të kushteve dhe rregullave kishte edhe për sektorët tjerë ekonomik mirëpo në nivele margjinale. Këto shtrëngime kryesisht reflektojnë rritjen e normës së interesit në kredi. Në anën tjetër, kërkesa për kredi shënoi rritje deri në një masë nga dy sektorë ekonomik. Sektori me kërkesën më të rritur për financim ishte ai i ndërtimtarisë me indeks pozitiv 0.14, rritje e deklaruar nga pesë banka. Njëkohësisht, sektori i dytë me kërkesë të rritur ishte sektori i patundshmërive rezidenciale me indeks pozitiv prej 0.09, rritje e deklaruar nga katër banka. Në anën tjetër, bankat deklaruan rënie deri në një masë të kërkesës për kredi nga sektori i tregtisë i cili gjeneroi indeks negativ 0.14.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë tremujorit të ardhshëm bankat pritet të aplikojnë ndryshime të vogla në ofertën kreditore për disa nga sektorët ekonomik. Kushtet dhe rregullat pritet të lehtësohen për të gjithë sektorët ekonomik për dallim nga tremujori aktual, ku sektorët me indeksin pozitiv më të lartë pritet të jenë ai i prodhimtarisë (indeks pozitiv 0.15) dhe ai i tregtisë (indeks pozitiv prej 0.12). Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritet të ketë lëvizje pozitive. Konkretisht, pritet rritje e kërkesës nga sektori i shërbimeve dhe ndërtimtarisë (indeks pozitiv 0.18 dhe 0.14, respektivisht), gjithashtu pritet rritje e kërkesës në nivel më të ulët nga sektori i patundshmërive rezidenciale me indeks pozitiv prej 0.11.



## Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend. Kjo ndodhë duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKBK është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e çmimeve në vend. Kjo ndihmon në plotësimin e publikimeve tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklaramentit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e kaluar, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt të vitit 2023 si dhe për vitin 2023 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

## Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë në objektiven e stabilitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit.

Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se ato shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore, shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

## Përmbledhja e rezultateve

Në bazë të anketës së realizuar në tetor të vitit 2023, bankat kanë vlerësuar nivel më të ulët të inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin paraprak. Ato presin një nivel lehtësisht më të lartë të inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2023. Për vitin 2023, bankat presin që niveli i inflacionit të jetë 4.7 përqind, një ngadalësim i theksuar kundrejt shkallës prej 11.6 përqind sa ishte në vitin 2022.

Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2023 tregojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 3.2 përqind, ndërsa për tremujorin e katërt të vitit 2023, bankat presin se norma mesatare e inflacionit do të jetë 4.2 përqind. Shumica e bankave presin që inflacioni në tremujorin e katërt do të jetë mbi 4 përqind ndërsa bankat tjera presin se inflacioni do të jetë nën këtë nivel.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM3 2023	TM4 2023	2023
1	5.5%	5.7%	5.6%
2	3.3%	2.5%	2.5%
3	4.2%	4.2%	5.2%
4	4.2%	3.6%	5.3%
5	4.2%	5.0%	5.0%
6	3.2%	4.3%	5.2%
7	4.2%	4.6%	4.9%
8	4.2%	3.8%	3.8%
9	3.3%	3.7%	3.8%
10	4.3%	5.0%	5.4%
<b>Mesatarja</b>	<b>4.1%</b>	<b>4.2%</b>	<b>4.7%</b>

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.


Figura 8 ilustron shpërndarjet e raportuara të probabilitetit, treguar me një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit. Kjo pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur disa faktorë kyç që kanë ndikuar dhe pritjet të ndikojnë në shkallën e inflacionit, përfshirë rritjen e normave të interesit nga Rezerva Federale në SHBA, Banka Qendrore Evropiane, dhe Banka e Anglisë. Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, së bashku me ngadalësimin e rritjes së ekonomisë globale, mund të kenë ndikuar në ngadalësimin e rritjes së inflacionit, duke marrë parasysh varësinë e madhe të ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave, etj.

Përveç kësaj, faktorë të tjerë që kanë ndikuar që inflacioni të mbetet ende i lartë përfshijnë lutën në Ukrainë, me ndikim të rëndësishëm nga Rusia dhe Ukraina si furnizues të lëndëve të para, lufta në Gaza. Presionet e brendshme për rritjen e pagave, së bashku me presionet nga ecuria e çmimeve të energjisë pas vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për rritjen e tarifave në masën prej 15%, pritjet të kenë ndikim edhe në muajt në vazhdim, sidomos gjatë periudhës së dimrit.

Si përfundim, bankat presin që të ketë një ngadalësim të rritjes së inflacionit gjatë vitit 2023. Megjithatë, pritjet për ngadalësim mund të ndikohen negativisht nga zhvillimet globale dhe pasiguria rreth tyre, si dhe kushteve jo të favorshme atmosferike, të cilat rezultuan me rendiment më të ulët të kulturave bujqësore.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2023 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)